



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

Këshilli për Rregulloren, Mandatet dhe Imunitetin

PROCESVERBAL

Tiranë, më 28.03.2019, ora 9:30

Drejton mbledhjen:

Gramoz Ruçi – Kryetar i Kuvendit

Rendi i ditës:

Shqyrtimi i vendimeve nr. 90, 91 dhe 92 datë 27.3.2019 të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve “Për dhënien e mandatit të deputetit të Kuvendit kandidatit të listës shumemërore të Partisë Lëvizja Socialiste për Integrim në Qarkun Shkodër, dhe të Partisë Demokratike në Qarqet Elbasan dhe Vlorë për plotësimin e vakancave të njoftuara nga Kuvendi i Shqipërisë si dhe verifikimi i mandatit të deputetëve znj. Amra Barova dhe z. Arben Elezi e z. Adriatik Alimadhi.

Marrin pjesë:

Gramoz Ruçi, Klotilda Bushka, Ermonela Felaj, Musa Ulqini, Myslym Murrizi.

Mungojnë:

Damian Gjikhuri, Vasilika Hysi, Ulsi Manja

HAPET MBLEDHJA

Gramoz Ruçi – Fillojmë mbledhjen e sotme të Këshillit për Rregulloren, Mandatet dhe Imunitetin.

Nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve janë depozituar në Kuvend edhe 3 vendimet nr. 90, 91 dhe 92 datë 27.03.2019 për dhënien e mandatit të deputetit 2 kandidatëve të listës shumemërore të Partisë Demokratike, në Qarkun Elbasan dhe Qarkun Vlorë si dhe 1 kandidat të listës shumemërore të Partisë Lëvizja Socialiste për Integrim në Qarkun Shkodër.

Në mbështetje të nenit 13 të Rregullores, Këshilli për Rregulloren, Mandatet dhe Imunitetin mblidhet për të bërë verifikimin e mandatit të deputetit që zgjidhet gjatë legjislaturës. Me vendim të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve kanë fituar mandatin e deputetit, konkretisht:

- z. Arben Elezi nga lista shumemërore e Partisë Demokratike Qarku Elbasan.
- znj. Amra Barova nga lista shumemërore e partisë Lëvizja Socialiste për Integrim, Qarku Shkodër.

- z. Adriatik Alimadhi nga lista shumemërore e Partisë Demokratike, Qarku Vlorë.

Vendimet e Komisionit Qendror dhe drafraportin i keni të gjithë përpara.

A ka ndonjë mendim, ndonjë vërejtje apo ndonjë sugjerim nga anëtarët e Këshillit në lidhje me mandatin e deputetëve të rinj?

Nuk ka.

Atëherë, jemi dakord!

Anëtarët e Këshillit për Rregulloren, Mandatet dhe Imunitetin janë dakord me vendimet e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.

Atëherë, raporti i Këshillit do t'i kalojë seancës plenare për miratim!

Relatorja Znj. Klotilda Bushka do të lexojë raportin e përmbledhur.

Mbledhja mbyllet.

MBYLLET MBLEDHJA